

Abstrakt

Ky punim shkencor apo temë diplome ka në fokus të tij Rregullimin dhe funksionimin e Konkurrencës sipas Legjislacionit të Kosovës dhe Shqipërisë, me theks të veçantë Abuzimin me Pozitën Dominuese. Përmes këtij punimi është ofruar një hulumtim i cili do të jetë i dobishëm, jo vetëm për teoricienët por edhe zbatuesit e praktikës duke realizuar edhe krahasimet në mes legjislacionit të Kosovës dhe Shqipërisë ku do të ndriçohen të përbashkëtat dhe dallimet në mes tyre. Ndër qëllimet kryesore të institucioneve të Autoritetit të Konkurrencës në Kosovë dhe Shqipëri janë: politika e konkurrencës, lufta kundër marrëveshjeve të ndaluara, lufta kundër abuzimeve me pozitën dominuese, etj.

Gjithashtu, hulumtimet që i kam realizuar përmes anketës dhe pyetësorit janë ofruar të dhëna aktuale lidhur me temën dhe kjo do të ndikoj pozitivisht për hulumtuesit e ri, studiuesit dhe zbatuesit e praktikës, të cilët do të kenë një pasqyrë të qartë rreth Rregullimit dhe funksionimit të Konkurrencës sipas Legjislacionit të Kosovës dhe Shqipërisë, me theks të veçantë Abuzimit me Pozitën Dominuese.

Abstract

This scientific paper or diploma thesis has in its focus the Regulation and functioning of Competition according to the Legislation of Kosovo and Albania, with special emphasis on the Abuse of Dominant Position. Through this paper is presented a research which will be useful, not only for theorist but also practitioners by realizing the comparisons between the legislation of Kosovo and Albania where the commonalities and differences between them will be clarified. Among the main goals of the institutions of the Competition Authority in Kosovo and Albania are: competition policy, the fight against prohibited agreements, the fight against abuses with a dominant position, etc.

Also, the research I conducted through the survey and the questionnaire provided current data on the topic and this will have a positive impact on young researchers, researchers and practitioners, who will have a clear picture of the Regulation and functioning of Competition according to the Legislation of Kosovo and Albania, with special emphasis on Abuse of Dominant Position.